



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 230 prot.

Tiranë, më 28. 01.2025

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 1673/1, DATË 03.08.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË  
TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË  
ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. ARDIT  
SKANDAJ"**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Ardit Skandaj nr. 3386 prot., datë 15.12.2023 dhe nr. 3388 prot., datë 15.12.2023, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistrates N.B. me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 1673/1 prot., datë 03.08.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Ardit Skandaj", bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Lezhë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga " Shtraus", Lezhë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Dëshira Pasko**

